



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

ADGJA.nr.1/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Kryetari i Gjykatës Valon Totaj, duke vendosur përkitazi me ankesën disiplinore të parashtruar nga av.N.E., nga P....., ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, K.P., lidhur me vendosjen në lëndën Ac.nr.2372/21, të Gjykatës së Apelit në Kosovë, në kuptim të nenit 9, paragrafi 1.1 dhe 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me datën 31.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa disiplinore e parashtruar nga av.N.E., nga P....., ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, K.P., lidhur me vendosjen në lëndën.Ac.nr.2372/21, të Gjykatës së Apelit në Kosovë.

A r s y e t i m

Me datën 16.01.2024, nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Gjykata e Apelit e Kosovës, e ka pranuar ankesën e av.N.E., nga P..... Në ankesë i njëjti ka pretenduar se gjyqtari K.P. pa bazë ligjore e ka aprovuar ankesën e të autorizuarit të të paditurve me ç’rast ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar juridikisht përkundër faktit se dy aktgjykime ishin në favor të paditësve. Tutje ka theksuar se brenda periudhës së paraparë ligjore kemi parashtruar revizion kundër këtij Aktgjykimi dhe me vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr.407/23, të datës 29.11.2023 lënda i është kthyer Gjykatës së Apelit për rivendosje. Nga fakti se gjyqtari i çështjes K.P. e ka vendosur këtë çështje civile duke i injoruar dy aktgjykime të nxjerra në favor të paditësve, të nxjerra nga Gjykata Themelore në Prizren, fuqimisht dyshojmë në objektivitetin e tij në vendosje të kësaj çështje civile.

Kryetari i Gjykatës, pas pranimit dhe vlerësimit të ankesës, me datë 29.01.2024, nga gjyqtari i Gjykatës së Apelit të Kosovës, në lëndën Ac.nr..2372/21, ka kërkuar deklaram lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi av.N.E..

Gjyqtari K.P., ka dhënë deklaratë me datën 30.01.2024, ku ka theksuar se në mesin e shumë lëndëve në punim ka qenë edhe lënda Ac.nr.2372/2021 dhe kryetar i kolegjit kam qenë unë ndërsa si anëtar të kolegjit kanë qenë gjyqtarët M.S dhe M.K. Tutje ka theksuar se vendosja ne këtë lëndë dhe lëndët tjera gjerë më tani të gjykuara ka qenë në bazë të provave të cilat kanë qenë në shkresat e lëndës dhe bazuar në bindjen e lirë të gjyqtarëve, përkatësisht anëtarëve të kolegjit, ku vendimi për rastin konkret është marrë unanimisht. Gjithashtu ka theksuar se nuk kam njohuri që kjo lëndë është prishur nga Gjykata Supreme e Kosovës sepse e njëjta ende nuk është kthyer në Gjykatën e Apelit, përkatësisht në zyrën time.

Kryetari i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe deklaratës së gjyqtarit K.P., ka gjetur se:

- ankesa e ankuesit av.N.E., është **e pabazuar.**

Kryetari i Gjykatës, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga ankuesi si dhe deklaratës së gjyqtarit, vlerësoi se pretendimet ankimore sa i përket mënyrës së vendosjes, janë pretendime të pabazuara dhe të paqëndrueshme, për faktin se gjyqtarët janë të pavarur në vendimmarrje, pavarësi kjo e cila i'u është garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Po ashtu gjyqtarët janë të pavarur në punë e tyre, vendosin sipas ligjit dhe vendimet merren në bazë të provave që shqyrtohen dhe verifikohen në shqyrtim kryesor. Sipas vlerësimit të kryetarit, pavarësia individuale, është pavarësia e gjyqtarëve në kryerjen e funksionit të tyre gjyqësor, që nënkupton se gjyqtarët duhet të jenë meritore, objektiv, neutral dhe të liruar nga çdo ndjenjë e ndikimit kur ushtrojnë funksionin e tyre gjyqësor.

Lidhur me pavarësinë në vendimmarrje nuk duhet të ketë asnjë ndërhyrje të pavend apo të pajustificuar në procesin gjyqësor dhe nuk duhet që vendimet gjyqësore të gjykatave t'i nënshtrohen ndryshimit. Në rastin konkret Kryetari i Gjykatës nuk ka kompetencë që të ndryshojë vendimet gjyqësore të nxjerra nga gjyqtari apo kolegji i gjyqtarëve dhe se pala e pakënaqur ndaj

aktgjykimit të Gjykatës së Apelit nëse vlerëson se vendimi është marrë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese, i njëjti eventualisht mund të parashtrijë kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ndërsa nëse vlerëson se ka baza të tjera ankimore, atëherë i njëjti eventualisht mund t'i drejtohet Gjykatës Supreme.

Kryetari i Gjykatës vlerësoi, se në rrethanat aktuale të çështjes nuk ka bazë për të hapur një hetim disiplinor lidhur me vendosjen e çështjes së parashtruesit të ankesës, meqë me prova të shqyrtuara nuk është vërtetuar se gjyqtari K.P. ka bërë shkelje të Kodit të Etikës.

Ndërkaq, për punën profesionale të gjyqtarit apo kolegjit, kompetent për vlerësim profesional është Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve i cili vepron në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës, ku i njëjti bën vlerësimin e performancës për gjyqtarët.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit në kuptim të nenit 9, paragrafi 1, pika 1.1. të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

ADGJA.nr.1/2024, me datë 31.01.2024

Kryetari i Gjykatës

Valon Totaj

Vendimi t'i dorëzohet:

- Parashtruesit të ankesës,
- Gjyqtarit K.P.
- Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Një kopje në shkresa të lëndës,